



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2020:082627

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01181148

**P.nr.156/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK**, Gjyqtari Burim Çaka me procesmbajtësen Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit L.M nga rruga “1...” Komuna e Kaçanikut, i akuzuar për shkak të veprës penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.551/20 të datës 08.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, jo publik më datë 22.09.2020, në praninë e Prokurores së Shtetit Ajtene Zoni dhe të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 12.10.2020 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:** L.M nga rruga “1...” Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ... nga i ati ..., e ëma D..., e gjinisë I..., me numër personal ..., beqar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i pa gjykuar më parë, mbrohet në liri

### **ËSHTË FAJTOR**

Më datë 06.03.2020, rreth orës 23:50, në rrugën “Ismail Raka” në Kaçanik, saktësisht në kafiterinë “M...”, i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit kokainë, e cila i është gjetur në këpucën e tijë, si dhe një pako me letra – rizlla për mbështjelljen e substancave narkotike pas kontrollimit në këtë lokal nga njësia e hetimeve rajonale, në peshë neto prej 0.18 gram të cilin e posedonte pa leje

Me të cilin veprim ka kryer veprën penale: Posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurin e

## **G J Y K O N**

I. Me dënim me gjobë në shumën prej 400 € (Katër qind) eurove, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 2 këste afat prej 2 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk do të mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti dënim do ti zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur për çdo 20 euro 1 dite burgim. Nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës më këste do të revokohet.

II. Në bazë të nenit 69 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit kokainë me peshë prej 0.18 gram.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€ € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.551/20 të datës 08.07.2020, kundër të pandehurit L.M nga rruga “1...” Komuna e Kaçanikut, i akuzuar për shkak të veprës penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par 2 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurin të shpallet fajtor dhe t’i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 22.09.2020,

Seanca nuk ishte publike për shkak të pandemisë Covid 19 dhe vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK-Nr.85/2020, të datës 29 maj 2020

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Prokurorja e Shtetit duke shprehur mendimin e sajë lidhur me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, ngase e njëjta është bërë konform

nenit 248 të KPP-së dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'i shqiptoj dënim sipas ligjit.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: I pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht; - Pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i pandehurit e ka pranuar fajësinë, rrethanë lehtësuese se është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tjera penale. Rrethana rënduese nuk gjeti.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi dënim duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit, andaj dënimin me gjobë të pandehurit ia shqiptoi duke u bazuar në mundësinë ekonomike të pagesës së tij dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Në mbështetje të nenit 69 të KPRK –së është konfiskuar në mënyrë të përherëshme substanca narkotike e llojit kokainë me peshë prej 0.18gram

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€ dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**Dega në Kaçanik**

**P.nr.156/20 datë 12.10.2020**

**Procesmbajtësja**

Suzane Rudi

**Gjyqtari Burim Çaka**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.